



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALIQ
KËSHILLI I BASHKISË**

Nr. 2029 Prot.,

Maliq, më 22.05.2020

NJOFTIM

LËNDA: Mbi zhvillimin e mbledhjes së radhës së Këshillit të Bashkisë Maliq

DREJTUAR: KËSHILLIT BASHKIAK MALIQ

KRYETARIT TË BASHKISË MALIQ

Të nderuar,

Në mbështetje të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” datë 17.12.2015, neni 53, “Funksionimi i këshillit bashkiak” pika 2, nenit 5 të Aktit Normativ nr.3, datë 15.03.2020 “Për marrjen e masave të veçanta administrative gjatë kohëzgjatjes së periudhës së infeksionit të shkaktuar nga COVID-19”, ju njoftojmë se mbledhja radhës e Këshillit të Bashkisë Maliq do të zhvillohet ditën e premte, datë **29.05.2020, ora 10:00**, në sallën e mbledhjeve të Këshillit me këtë

Rend Dite;

- 1- P-V “Për miratimin e Ndhmës Ekonomike deri në 6% të fondit për muajin prill 2020”.
- 2- P-V “Për miratimin e sistemit të pikëzimit të qirasë dhe nivelin maksimal të subvencionit të qirasë në tregun e lirë” nga programi i Strehimit Social.
- 3- P-V “Për përcaktimin e vlerës maksimale të subvencionit të qirasë në tregun e lirë për kategoritë që gëzojnë përparësi”.
- 4- Informacion “Mbi shpërndarjen e pakove ushqimore për familjet në nevojë në Bashkinë Maliq gjatë periudhës së pandemisë së COVID-19”.
- 5- P-V “Për dhënie ndihme financiare për familjen e z. Albert Gongo banesa e të cilit u shkatërrua pjesërisht si shkak i rënies së zjarrit”.
- 6- P-V “Mbi përfshirjen e objektit me nr. pasurie 701/9 me emërtimin Pallat banimi në procedurën e privatizimit të ndodhur në fshatin Podgorie, NJA Vreshtas, Bashkia Maliq”.
- 7- Raporti i Performancës së Bashkisë Maliq, për vitin 2019.
- 8- Njohja e Këshillit Bashkiak me Raportin përmbledhës dhe Inventaret e vitit 2019, Bashkia Maliq.
- 9- Miratimin e Rregullores së Këshillit Bashkiak “Paraqitja dhe shqyrtimi i ankesave, vërejtjeve, kërkesave, peticioneve dhe iniciativave qytetare” sipas propozimit të (AMVV-së).
- 10- Diskutime të ndryshme.

Shënim:Rregullorja e Këshillit Bashkiak për “Shqyrtimin e Ankesave, Vëretjeve, Kërkesave, Peticoneve dhe Iniciativave Qytetare, si dhe Raporti i Performanës për Bashkinë Maliq, viti 2019 do ju vihet në dispozicion në mënyrë elektronike (e-mail).

Ju Faleminderit!

**NË MUNGESË DHE ME POROSI
ZV/KRYETARI I KËSHILLIT**

Gentiana DRABO

